# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2019 – Numri: 180

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E premte, 27 dhjetor 2019**

## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Ligj nr. 71/2019 datë 17.10.2019 | Për Korporatën e Investimeve Shqiptare.................................................. | 13875 |
| Ligjnr. 75/2019 datë 4.11.2019 | Për rininë.................................................................................................. | 13880 |
| Vendim i Kuvendit nr. 143/2019, datë 18.12.2019 | Për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e afatit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore.................................................................................................. | 13886 |
| Vendim i Kuvendit nr. 144/2019, datë 18.12.2019 | Për rrëzimin e dekretit nr. 11 343, datë 6.11.2019, të Presidentit të Republikës, "Për kthimin e ligjit nr. 71/2019 'Për Korporatën e Investimeve Shqiptare'" ................................................................ | 13886 |
| Vendim i Kuvendit nr. 145/2019, datë 18.12.2019 | Për rrëzimin e dekretit nr. 11 367, datë 25.11.2019, të Presidentit të Republikës, "Për kthimin e ligjit nr. 75/2019, 'Për rininë'" ..................... | 13887 |
| Vendim i Kuvendit nr. 148/2019, datë 18.12.2019 | Për shkarkimin e zotit Arben Malaj nga detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë............................................................ | 13887 |
| Vendim i Kuvendit nr. 149/2019, datë 18.12.2019 | Për lirimin nga detyra të një anëtari, i caktuar kryetar, të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare......... | 13887 |
| Vendim i Kuvendit nr. 150/2019, datë 18.12.2019 | Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.................................................... | 13887 |
| Vendim i Kuvendit nr. 151/2019, datë 18.12.2019 | Për caktimin e kryetarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.................................................... | 13888 |
| Vendim i Kuvendit nr. 152/2019, datë 18.12.2019 | Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në Komisionin e Posaçëm për Reformën Zgjedhore........................................................................... | 13888 |
| Urdhër i ministrit të Kulturës nr. 690, datë 15.11. 2019 | Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore dhe sekretarisë teknike...................... | 13888 |

| | | |
|---|---|---|
| Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 441, datë 4.12.2019 | Për miratimin e planit vjetor minerar 2019................................................ | 13893 |
| Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 783, datë 18.12.2019 | Për caktimin e personave të autorizuar që do të përdorin portalin qeveritar për shërbimet *online* prej datës 1.1.2020.......................................... | 13911 |

**LIGJ**
**Nr. 71/2019**

# PËR KORPORATËN E INVESTIMEVE SHQIPTARE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

## KREU I
## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1
### Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim krijimin e Korporatës së Investimeve Shqiptare (në vijim Korporata), si dhe përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së saj.

### Neni 2
### Objektivat e Korporatës

Korporata ka këta objektiva kryesorë:
1. Nxit zhvillimin ekonomik nëpërmjet projekteve të investimit në nivel qendror, vendor dhe rajonal, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit.
2. Vënien në përdorim më eficiencë të pronave shtetërore.
3. Kryerjen e investimeve duke mobilizuar kapital shtetëror dhe/ose privat.

### Neni 3
### Parimet e përgjithshme

1. Në përmbushjen e funksioneve të saj, Korporata udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:
a) përparësia e zhvillimit ekonomik në nivel qendror, vendor dhe rajonal, si dhe lidhjen me politikat shtetërore të zhvillimit;
b) pavarësia në vendimmarrje, në kryerjen e funksioneve, në propozimin dhe zbatimin e projekteve;
c) përfitueshmëria, fizibiliteti ekonomik dhe tregtar i projekteve;
ç) trajtimi në mënyrë të drejtë dhe të barabartë i palëve me të cilat bashkëpunon;
d) ruajtja dhe zhvillimi i vlerës së aseteve;
dh) zbatimi me efektivitet, eficiencë, dhe ekonomicitet i funksioneve dhe detyrave;
e) nevojshmëria dhe proporcionaliteti në marrjen e masave për realizimin e objektivave;
ë) respektimi i parimit të konkurrencës së lirë dhe efektive, në procedura dhe treg, në përputhje me kuadrin ligjor mbi konkurrencën dhe ndihmën shtetërore;
f) zbatimi i procedurave transparente, të thjeshta dhe të kontrollueshme;
g) integriteti dhe ndalimi i konfliktit të interesave në kryerjen e funksioneve dhe marrëdhëniet me partnerët dhe palët e treta;
gj) përgjegjësia ndaj palëve të interesuara dhe partnerëve;
h) përgjegjësia për zhvillimin e politikave sociale.
2. Përveç parimeve të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, Korporata udhëhiqet edhe nga parime e kritere të tjera, të përcaktuara në statut dhe në aktet e tjera të saj, si dhe në marrëveshjet respektive me institucionet dhe/ose palët e treta.

### Neni 4
### Statusi juridik

1. Korporata krijohet si person juridik, e organizuar në formën e një shoqërie aksionare, sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe këtij ligji.
2. Autoriteti publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të Korporatës është ministri përgjegjës për ekonominë.
3. Institucionet financiare ndërkombëtare të zhvillimit mund të zotërojnë aksione të Korporatës. Procedurat, kriteret dhe formula e pjesëmarrjes së institucioneve financiare ndërkombëtare të zhvillimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Korporata ka stemën, logon, dhe vulën e saj zyrtare, të cilat miratohen nga Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit Mbikëqyrës.
5. Korporata ka selinë në Tiranë dhe ka të drejtën të krijojë struktura të tjera, sipas

procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 5
**Funksionet e Korporatës**

Funksionet kryesore të Korporatës janë:

1. Zhvillimi dhe menaxhimi i pronave dhe projekteve në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit.
2. Këshillimi i institucioneve publike dhe/ose private në hartimin, analizimin, dhe rekomandimin e projekteve.
3. Financimi ose bashkëfinancimi i projekteve ose subjekteve për qëllime të veçanta (SPV) të ngritura për realizimin e tyre.
4. Me autorizim të Këshillit të Ministrave, merr rolin e zhvilluesit, sipas legjislacionit për Zonat Teknologjike dhe Zhvillimit Ekonomik.
5. Këshilli i Ministrave mund të autorizojë Korporatën të kryejë funksione të tjera, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 6
**Burimet financiare**

1. Korporata mund të financohet nga:

a) buxheti i shtetit për kapitalizimin e saj;

b) kontributi i institucioneve financiare ndërkombëtare;

c) të ardhurat e përfituara nga aktivitetet e saj dhe shërbimet e ofruara;

ç) donacionet në përputhje me legjislacionin në fuqi;

d) burime të tjera, të lejuara nga legjislacioni në fuqi dhe aktet e saj të brendshme.

2. Financimi i Korporatës nga buxheti i shtetit do të jetë në përputhje me legjislacionin e ndihmës shtetërore.

3. Detyrimet financiare të Korporatës nuk i transferohen buxhetit të shtetit. Përgjegjësia për shlyerjen e detyrimeve financiare është detyrim i Korporatës.

Neni 7
**Transferimi i pronave shtetërore**

1. Prona shtetërore, në kuptim të këtij ligji, janë pronat e luajtshme, të paluajtshme shtetërore, të drejtat reale mbi to, të drejtat e shfrytëzimit, si dhe titujt e pronësisë së shtetit mbi kapitalin e shoqërive tregtare dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore. Kur Korporata identifikon prona shtetërore me interes për të realizuar projekte investimi, i propozon Këshillit të Ministrave, nëpërmjet ministrit përgjegjës për ekonominë, transferimin e tyre te Korporata. Me transferim kuptohet kalimi i së drejtës së përdorimit dhe/ose i së drejtës së pronësisë të pronave shtetërore nga pushteti qendror ose vendor te Korporata.

2. Kriteret dhe procedurat për dhënien e pronës, e cila ka kaluar te Korporata, sipas pikës 1, të këtij neni, me qira, enfiteozë, *leasing*, përdorimit, transferimit, shitjes, përdorimit si kolateral, ose të përdorimit në forma të tjera, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU II
MASA MBËSHTETËSE

Neni 8
**Mbështetja me infrastrukturë ndihmëse**

1. Për zhvillimin dhe zbatimin e një projekti investimi, Korporata mund të mbështetet nga institucionet shtetërore me infrastrukturë ndihmëse, të tilla si: rrugë, ujësjellës, kanalizime, energji elektrike dhe telekomunikacion.
2. Korporata kontribuon proporcionalisht ose sipas mundësive në realizimin e infrastrukturës ndihmëse.
3. Ministria përgjegjëse për ekonominë, në bashkëpunim me ministritë e tjera, shqyrton dhe verifikon nevojat e kërkesat për infrastrukturë ndihmëse, si dhe vlerëson koston e përafërt për realizimin e saj, kosto kjo që nuk duhet të jetë disproporcionalisht e lartë, në raport me vlerën dhe rëndësinë e projektit të investimit. Në rast se kërkesa për mbështetje me infrastrukturë ndihmëse vlerësohet pozitivisht, ministria përgjegjëse për ekonominë përgatit dokumentacionin e nevojshëm.
4. Mbështetja me infrastrukturë ndihmëse miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për ekonominë.

Neni 9
**Marrja e licencave/lejeve**

Për marrjen e licencave/lejeve, pas dorëzimit të dokumentacionit nga Korporata, institucionet /entet/autoritetet publike, brenda 15 ditëve pune, kthejnë përgjigje mbi kërkesën për miratim të licencave/lejeve, sipas legjislacionit në fuqi. Përjashtimisht, për shkaqe të arsyeshme që lidhen me kompleksitetin e licencave/lejeve, afati shtyhet vetëm një herë, për një periudhë kohore prej 30 ditë pune.

Neni 10
**Regjimi i prokurimit**

1. Për kontratat publike, të cilat financohen plotësisht nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar, zbatohen rregullat e prokurimit që parashikohen nga kjo organizatë ose institucion. Në rastin e kontratave publike që bashkëfinancohen në shumicën e tyre nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar, palët bien dakord për procedurat e zbatueshme të prokurimit.

2. Për kontratat publike, të cilat financohen nga buxheti i shtetit, zbatohen dispozitat e ligjit për prokurimin publik në fuqi.

KREU III
STRUKTURA ORGANIZATIVE

Neni 11
**Organet drejtuese të Korporatës**

Organet e Korporatës janë:
1. Asambleja e Përgjithshme.
2. Këshilli Mbikëqyrës.
3. Drejtori Ekzekutiv.
4. Bordi Këshillimor.

Neni 12
**Asambleja e Përgjithshme**

Asambleja merr vendime për çështjet e mëposhtme:
1. Miratimin e statutit të Korporatës dhe ndryshimeve të tij.
2. Miratimin e strategjisë së Korporatës.
3. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë së Korporatës.
4. Çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ky ligj, ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, si dhe statuti i Korporatës, përveç atyre që i janë dhënë me këtë ligj Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 13
**Këshilli Mbikëqyrës**

1. Këshilli Mbikëqyrës ka numër tek anëtarësh, jo më pak se 5, ku shumica janë të pavarur.
2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërohen dhe lirohen nga Asambleja e Përgjithshme.
3. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës udhëhiqen nga parimi i mirëbesimit, duke përfshirë detyrimin për kujdesin, besnikërinë, konfidencialitetin, integritetin dhe pavarësinë në raport me Korporatën.
4. Anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës zgjidhen ata persona që:
a) nuk kanë qenë të dënuar me vendim gjykate të formës së prerë, për kryerjen e një vepre ose kundërvajtjeje penale;
b) zotërojnë të paktën “master shkencor” ose më lart në fushën e ekonomisë, financave, biznesit, drejtësisë, ose fusha te ngjashme, si dhe të paktën 7 vite pune në pozicion drejtues në sektorin publik ose privat;
c) kanë shtetësi shqiptare ose të huaj.
5. Shpërblimi për anëtarin e Këshillit Mbikëqyrës nuk është më pak se 1/3 e pagës së Drejtorit Ekzekutiv.

Neni 14
**Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës**

1. Këshilli Mbikëqyrës siguron që Korporata gëzon autonomi operacionale në veprimtarinë e saj dhe ka këto kompetenca:
a) propozon për miratim pranë Asamblesë statutin e Korporatës dhe ndryshimet në të;
b) propozon për miratim pranë Asamblesë strategjinë e Korporatës;
c) miraton planin e biznesit dhe planet vjetore të punës;
ç) miraton projektet e investimit;
d) miraton ngritjen e strukturave të tjera të Korporatës;

dh) kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave dhe projekteve të investimit të Korporatës;

e) miraton treguesit e performancës dhe monitoron performancën e saj;

ë) kujdeset që Korporata të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;

f) siguron që pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, kryhen me saktësi nga Korporata;

g) siguron që auditimi i Korporatës kryhet të paktën një herë në vit;

gj) emëron dhe liron Drejtorin Ekzekutiv;

h) përcakton pagat dhe shpërblimin e organeve dhe administratës së Korporatës;

i) krijon komitete të posaçme lidhur me kontrollet e brendshme, përputhshmërinë ligjore dhe etike në Korporatë;

2. Këshilli Mbikëqyrës miraton procedurat dhe kriteret për shqyrtimin dhe miratimin e projekteve.

3. Këshilli Mbikëqyrës bashkëpunon me Bordin Këshillimor në marrjen e vendimeve.

4. Këshilli Mbikëqyrës përmbush edhe detyra të tjera të parashikuara nga ky ligj, ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, si dhe statuti i Korporatës.

Neni 15
**Drejtori Ekzekutiv**

1. Drejtori Ekzekutiv është përfaqësuesi ligjor i Korporatës.

2. Drejtori Ekzekutiv përgjigjet përpara Këshillit Mbikëqyrës.

3. Drejtori Ekzekutiv emërohet dhe lirohet nga Këshilli Mbikëqyrës. Kushtet, afatet dhe rregullat e emërimit, performancës dhe lirimit përcaktohen në aktet e brendshme të Korporatës dhe në kontratën me Drejtorin Ekzekutiv.

4. Drejtor Ekzekutiv emërohet personi që:

a) nuk ka qenë i dënuar me vendim gjykate të formës së prerë, për kryerjen e një vepre ose kundërvajtjeje penale;

b) zotëron të paktën "master shkencor" ose më lart në fushën e ekonomisë, financave, biznesit, drejtësisë, ose fusha te ngjashme, si dhe të paktën 7 vite pune në pozicion drejtues në sektorin publik ose privat;

c) është shtetas shqiptar ose i huaj.

5. Paga e Drejtorit Ekzekutiv është konkurruese në raport me tregun, kredencialet dhe performancën në detyrë.

Neni 16
**Kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv**

1. Drejtori Ekzekutiv ka të drejtë dhe detyrohet, por pa u kufizuar:

a) të administrojë veprimtarinë e Korporatës;

b) të përfaqësojë Korporatën në marrëdhënie me të tretët;

c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Korporatës;

ç) të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, së bashku me propozimet për investimin e fitimeve;

d) të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcënojnë menaxhimin dhe performancën e Korporatës;

dh) të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të Korporatës, sipas legjislacionit në fuqi;

e) të raportojë përpara Këshillit Mbikëqyrës dhe Bordit Këshillimor për zbatimin e politikave dhe projekteve të investimit të Korporatës;

ë) të sigurojë zbatimin e vendimeve të Asamblesë, Këshillit Mbikëqyrës, legjislacionit dhe akteve të brendshme të Korporatës.

2. Drejtori Ekzekutiv bashkëpunon me Bordin Këshillimor për të propozuar projekte investimi për miratim në Këshillin Mbikëqyrës.

3. Drejtori Ekzekutiv përmbush edhe detyra të tjera të parashikuara nga ky ligj, detyra të tjera që kryen administratori, sipas përcaktimeve të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, si dhe statuti i Korporatës.

Neni 17
**Bordi Këshillimor**

1. Bordi Këshillimor përbëhet nga 9 anëtarë që zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme.

2. Tre anëtarë përfaqësojnë institucionet qendrore, dy anëtarë janë nga institucionet ndërkombëtare financiare të zhvillimit dhe katër anëtarë të tjerë janë të pavarur.

3. Anëtarët e Bordit Këshillimor zgjidhen ata persona që:

a) nuk kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre ose kundërvajtjeje penale;

b) zotërojnë të paktën "master shkencor" ose më lart në fushën e ekonomisë, financave, biznesit, drejtësisë, ose fusha te ngjashme, si dhe të paktën 7 vite pune në pozicion drejtues në sektorin publik ose privat;

c) kanë shtetësi shqiptare ose të huaj.

4. Bordi Këshillimor ka funksion këshillues në raport me Këshillin Mbikëqyrës dhe Drejtorin Ekzekutiv.

5. Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori Ekzekutiv kanë për detyrë informimin dhe bashkëpunimin me Bordin Këshillimor mbi iniciativat, projektet e propozuara për Korporatën dhe aktivitetet e tjera të saj.

6. Bordi Këshillimor rregullisht informon Këshillin Mbikëqyrës dhe Drejtorin Ekzekutiv mbi zhvillimin dhe zbatimin e planit të punës së Korporatës.

7. Bordi Këshillimor mund të krijojë komitete të specializuara për të kryer detyrat e tij.

8. Rregullat e funksionimit te Bordit përcaktohen në statutin e Korporatës dhe aktet e brendshme të saj.

9. Shpërblimi për anëtarin e Bordit Këshillimor nuk është më pak se 1/4 e pagës së Drejtorit Ekzekutiv.

Neni 18

**Administrata**

1. Struktura dhe organika e Korporatës miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës.

2. Marrëdhëniet e punës së personelit të Korporatës rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë dhe akteve të brendshme të Korporatës.

## KREU IV
## KONTABILITETI DHE AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE

Neni 19

**Kontabiliteti dhe llogaritë vjetore**

1. Korporata mban kontabilitetin e veprimtarisë së saj ekonomike në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

2. Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Mbikëqyrës përgatisin raportin e veprimtarisë, inventarët dhe llogaritë vjetore në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Neni 20

**Auditimi i pasqyrave financiare**

1. Auditimi i pasqyrave financiare të Korporatës kryhet sipas legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar, si dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

2. Këshilli Mbikëqyrës krijon një komitet të specializuar për auditimin financiar, me anëtarë dhe ekspertë të pavarur. Rregullat specifike për krijimin dhe funksionimin e komitetit të auditit përcaktohen në aktet e brendshme të Korporatës.

3. Kontrolli i Lartë i Shtetit kryen auditimin e përdorimit, administrimit të fondeve dhe pronës publike apo shtetërore, si dhe mbrojtjen e interesave ekonomikë dhe financiarë të shtetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionim e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

## KREU V
## DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 21

**Aktet nënligjore**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për miratimin e akteve nënligjore në zbatim të nenit 7, pika 2, të këtij ligji.

Neni 22

**Dispozita kalimtare**

Ministria përgjegjëse për ekonominë, brenda 90 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndjek procedurat e nevojshme për:

1. Sigurimin e kapitalit fillestar;
2. Zgjedhjen e anëtarëve të organeve drejtuese të Korporatës;
3. Miratimin e statutit të Korporatës;
4. Regjistrimin e Korporatës pranë regjistrit tregtar.

Neni 23
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.10.2019.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

**LIGJ**
**Nr. 75/2019**

**PËR RININË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
**Objekti**

Objekti i këtij ligji është mbrojtja e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse, krijimi i kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve, përcaktimi i funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, si dhe bashkëpunimi me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë.

Neni 2
**Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i veprimtarive, mekanizmave dhe autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve në Republikën e Shqipërisë dhe të të rinjve shqiptarë në diasporë, si dhe financimin e veprimtarive rinore, në kuadër të së drejtës së të rinjve për mbrojtje të veçantë nga shteti.

Neni 3
**Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
a) "Dialog i strukturuar" është dialogu i hapur, transparent, afatgjatë, i vazhdueshëm dhe sistematik ndërmjet të rinjve e organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë, si dhe institucioneve në nivel qendror e vendor, që mbulojnë çështje të lidhura me të rinjtë.
b) "Edukimi joformal për të rinjtë" është çdo veprimtari e organizuar dhe e përshtatur për të rinjtë, jashtë sistemit formal të arsimit, i bazuar në nevojat dhe interesat e të rinjve, parimet e vullnetarizmit dhe pjesëmarrjes aktive të të rinjve në proceset e të nxënit, nëpërmjet të cilit fitojnë kompetenca të nevojshme për zhvillimin e potencialit personal, pjesëmarrjes aktive në shoqëri dhe aksesit në tregun e punës.
c) "Hapësira rinore e sigurt" është çdo hapësirë ku ushtrojnë veprimtari të rinjtë dhe që plotësojnë standardet e përcaktuara në legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Në rastin e të rinjve me aftësi të kufizuara, këto hapësira duhet të zbatojnë elementet e përshtatjes së arsyeshme, në përputhje me shkallën dhe llojin e aftësisë së kufizuar.
ç)"Infrastrukturë rinore" është një hapësirë fizike, tokë, ndërtesë apo pjesë ndërtese e projektuar dhe e planifikuar veçanërisht për të rinjtë dhe veprimtaritë rinore.
d) "Organizatat rinore" janë persona juridikë jofitimprurës, të krijuar dhe të regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse, që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre përfaqësimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse.

dh) "Organizatat për të rinjtë" janë persona juridikë jofitimprurës, të krijuar dhe të regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse, që në fushën e veprimtarisë së tyre kanë për qëllim edhe mbrojtjen e zhvillimin e interesave të të rinjve dhe që kanë përvojë në zbatimin e programeve me ndikim për të rinjtë.

e) "Politikë rinore" është veprimtaria e qëndrueshme gjithëpërfshirëse e ndërmarrë nga ana e pushtetit qendror e vendor, që synon krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin personal të të rinjve dhe për pjesëmarrjen e tyre në jetën publike, sociale, ekonomike dhe kulturore, në nivel vendor dhe kombëtar, nëpërmjet veprimtarive që inkurajojnë zhvillimin e të rinjve në vend.

ë) "Subjekt i politikave rinore" është çdo organ, institucion dhe strukturë, në nivel qendror e vendor, që brenda fushës së vet të veprimtarisë ushtron përgjegjësi që prekin të rinjtë dhe harton politika rinore, si dhe aktorë të tjerë që marrin pjesë në procesin e hartimit e të zbatimit të politikave rinore.

f) "Të rinj" janë personat, i ri ose e re, që kanë mbushur moshën 15 vjeç deri në 29 vjeç.

Neni 4
**Parimet për mbështetjen e veprimtarisë së të rinjve**

1. Mbështetja dhe fuqizimi i të rinjve bazohet në parimet e mëposhtme:

a) parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit, të sanksionuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi;

b) parimin e mundësive të barabarta dhe garantimit të pjesëmarrjes së të rinjve në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse në fushat e arsimit, kërkimit shkencor, politikave financiare, punësimit, vullnetarizmit, mbrojtjes e përfshirjes sociale, shëndetësisë, kulturës, sportit, mjedisit, turizmit, drejtësisë, punëve të brendshme e të jashtme, integrimit dhe të mbrojtjes, teknologjisë së informacionit, sipërmarrjes dhe në fusha të tjera që inkurajojnë zhvillimin e të rinjve;

c) parimin e lirisë së organizimit të iniciativave rinore dhe të vetëqeverisjes së organizatave;

ç) parimin e subsidiaritetit.

2. Ky ligj garanton mbrojtjen e të rinjve shtetas shqiptarë me vendbanim ose vendqëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe të të rinjve shtetas të huaj ose persona pa shtetësi që kanë kërkuar mbrojtje ndërkombëtare, sipas legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë, si dhe të shtetasve të huaj me qëndrim të rregullt për motive të ndryshme, sipas legjislacionit në fuqi për të huajt.

KREU II
ORGANIZIMI INSTITUCIONAL

Neni 5
**Ministria përgjegjëse për rininë**

Ministria përgjegjëse për rininë ka këto kompetenca:

a) harton dhe propozon bazën ligjore, politikat, programet, strategjitë dhe veprimtaritë për rininë;

b) planifikon buxhetin për financimin e veprimtarive në fushën e rinisë;

c) harton dhe publikon raportet e vlerësimit mbi situatën e të rinjve;

ç) monitoron zbatimin e politikave, si dhe të veprimtarive rinore;

d) monitoron standardet për ndërtimin e hapësirave rinore të sigurta dhe të aksesueshme për të rinjtë";

dh) përfaqëson Republikën e Shqipërisë në nivelet dhe organizmat ndërkombëtarë për çështjet e rinisë;

e) përmbush detyrimet e anëtarësimit dhe bashkërendon pjesëmarrjen në programe e projekte ndërkombëtare në fushën e rinisë;

ë) bashkëpunon me njësitë e vetëqeverisjes vendore për politikat, projektet e programet në fushën e rinisë;

f) siguron ofrimin e veprimtarive për të rinjtë në bashkëpunim me institucione të tjera qendrore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me autoritetet të tjera, duke përcaktuar standardet në ofrimin e veprimtarive rinore dhe punës me rininë;

g) siguron zhvillimin e konsultimeve me të rinjtë lidhur me politikat dhe programet rinore në vend, si dhe programet e shkëmbimit rinor ndërkombëtar.

Neni 6
**Institucionet e tjera qendrore**

Institucionet e tjera qendrore, brenda fushës së veprimtarisë së tyre shtetërore, kanë për detyrë:

a) të hartojnë politika sektoriale, aktet ligjore e nënligjore të nevojshme për të drejtat e të rinjve, si dhe të kontribuojnë në hartimin e politikave dhe programeve ndërsektoriale, duke siguruar edhe marrjen e mendimit të të rinjve;

b) të parashikojnë në planet vjetore apo shumëvjeçare buxhetore fondet e nevojshme për përmbushjen progresive të të drejtave të të rinjve;

c) të bashkëpunojnë me institucionet përkatëse për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të të rinjve.

Neni 7
**Njësitë e vetëqeverisjes vendore**

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me funksionet e tyre, hartojnë dhe zbatojnë politikat vendore në fushën e rinisë, si dhe janë përgjegjëse për:

a) pasqyrimin dhe respektimin e të drejtave të të rinjve, duke përcaktuar objektivat dhe prioritetet, si dhe të garantojnë zbatimin e tyre;

b) krijimin e këshillit vendor të rinisë;

c) organizimin dhe koordinimin e veprimtarive që synojnë arritjen e objektivave vendore në fushën e mbrojtjes dhe të fuqizimit të të rinjve;

ç) organizimin dhe ofrimin e veprimtarive për të mbështetur mirëqenien dhe zhvillimin e të rinjve;

d) nxitjen e vullnetarizmit të të rinjve dhe edukimin joformal të tyre;

dh) financimin e krijimit dhe të zhvillimit të infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta;

e) krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë;

ë) parashikimin, në buxhetet e tyre, të fondeve për realizimin progresiv të të drejtave të të rinjve për zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore;

f) mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave, në bashkëpunim me institucionet e tjera, për situatën e të drejtave të të rinjve në territorin e tyre.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të aplikojnë për t'u mbështetur nga programet kombëtare dhe ndërkombëtare për rininë, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në fuqi.

3. Për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në këtë nen, njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve të përbashkëta, në përputhje me legjislacionin në fuqi për vetëqeverisjen vendore.

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë me organizatat për të rinjtë e organizatat rinore shqiptare në diasporë, për të mbajtur komunikimin me të rinjtë shqiptarë që janë larguar nga vendi për arsye studimesh ose të tjera, me qëllim angazhimin në aktivitetet që zhvillohen në Republikën e Shqipërisë.

Neni 8
**Institucioni përgjegjës për rininë**

1. Institucioni përgjegjës për rininë është person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për rininë, që financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme dhe ushtron veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Institucioni përgjegjës për rininë kryen këto funksione:

a) zbaton politikat dhe programet për të rinjtë;

b) organizon, administron, financon, koordinon dhe monitoron e mbikëqyr programet dhe projektet rinore;

c) bashkëpunon me organizma, institucione, donatorë dhe subjekte të tjera, vendase e të huaja, për prezantimin dhe zbatimin e politikave, programeve dhe veprimtarive rinore;

ç) mbështet ngritjen e kapaciteteve të njësive dhe strukturave në nivel qendror dhe vendor;

d) krijon dhe mirëmban bazën e aksesueshme të të dhënave për rininë;

dh) siguron financime nëpërmjet aplikimit në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat transferohen mbi bazë vjetore në rastet kur miratohet një projekt shumëvjeçar;

e) mbledh, administron dhe analizon të dhënat mbi situatën e të rinjve në bashkëpunim me institucionet e tjera dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore;

ë) raporton në mënyrë periodike pranë ministrisë përgjegjëse për rininë për situatën e të rinjve dhe zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ky ligj;

f) mbikëqyr veprimtarinë rinore dhe të punës me të rinjtë nga organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë, që përfitojnë mbështetje sipas parashikimeve të këtij ligji.

3. Mënyra e krijimit, organizimit dhe funksionimit të institucionit përgjegjës për rininë miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

**Këshilli Kombëtar i Rinisë**

1. Këshilli Kombëtar i Rinisë është organ këshillimor, që funksionon pranë ministrit përgjegjës për rininë. Këshilli Kombëtar i Rinisë ushtron kompetencat e mëposhtme:

a) i paraqet ministrit përgjegjës për rininë politikat prioritare, buxhetin dhe veprimtaritë në fushën e rinisë;

b) propozon drejtimet dhe programet kryesore për mbështetjen dhe fuqizimin e pjesëmarrjes së të rinjve;

c) jep mendim për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë dhe monitoron zbatimin e saj;

ç) miraton raportin vjetor mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë dhe situatës së të rinjve.

2. Këshilli Kombëtar i Rinisë kryesohet nga ministri përgjegjës për rininë dhe ka në përbërje 14 deri në 16 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Rinisë emërohen me urdhër të ministrit përgjegjës për rininë.

3. Kriteret dhe procedurat e zgjedhjes së anëtarëve, si dhe mënyra e organizimit dhe e funksionimit të Këshillit Kombëtar të Rinisë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

**Këshilli vendor i rinisë**

1. Këshilli vendor i rinisë është organ këshillimor, që funksionon pranë kryetarit të bashkisë. Këshilli vendor i rinisë ushtron kompetencat e mëposhtme:

a) këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;

b) vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;

c) propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë;

ç) bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë.

2. Këshilli vendor i rinisë kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe përbëhet nga të paktën 4 deri në 6 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë. Anëtarët e këshillit vendor të rinisë emërohen me urdhër të kryetarit të bashkisë.

3. Kriteret, procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të këshillit vendor të rinisë, si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të këshillit vendor të rinisë miratohen me vendim të këshillit bashkiak, duke iu referuar, për aq sa është e mundur, kritereve dhe procedurave të miratuara nga Këshilli i Ministrave për Këshillin Kombëtar të Rinisë.

Neni 11

**Organizatat rinore**

1. Organizatat rinore janë persona juridikë jofitimprurës, që krijohen dhe funksionojnë në bazë të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse.

2. Organizatat rinore duhet të përmbushin këto kritere:

a) të jenë të regjistruara në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse;

b) të kenë si objekt të veprimtarisë së tyre të parashikuar në statutin e organizatës aktivitete dhe veprimtari rinore;

c) të paktën, 70 për qind e anëtarëve të saj të jenë të rinj.

3. Zhvillimi i organizatave rinore inkurajohet dhe mbështetet nga programet dhe projektet vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare.

4. Regjistrimi si organizatë rinore në bazën e të dhënave për rininë, sipas nenit 18, të këtij ligji, bëhet me kërkesë të organizatës.

5. Organizatat rinore mund të përfitojnë financime nga organet e pushtetit qendror nëpërmjet fondit grant të dedikuar për rininë, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe nga burime të tjera të ligjshme.

Neni 12
**Organizatat për të rinjtë**

1. Organizatat për të rinjtë janë persona juridikë jofitimprurës, që krijohen e funksionojnë në bazë të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse.

2. Organizatat për të rinjtë duhet të përmbushin këto kritere:

a) të jenë të regjistruara në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse;

b) të kenë si objekt të veprimtarisë së tyre të parashikuar në statutin e organizatës aktivitete dhe veprimtari rinore;

c) të kenë zbatuar, të paktën për një periudhë 3-vjeçare në mënyrë të vazhdueshme projekte e programe me impakt te të rinjtë;

ç) të mos jenë në proces falimentimi dhe/ose likuidimi.

3. Regjistrimi si organizatë për të rinjtë në bazën e të dhënave për rininë, sipas nenit 18, të këtij ligji, bëhet me kërkesë të organizatës.

4. Organizatat për të rinjtë mund të përfitojnë financime nga organet e pushtetit qendror, nëpërmjet fondit të dedikuar për rininë, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe nga burime të tjera të ligjshme.

Neni 13
**Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore**

1. Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore është një organizatë që themelohet, organizohet dhe funksionon në zbatim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse dhe e ushtron veprimtarinë në përputhje me statutin e saj.

2. Të drejtën për të themeluar Organizatën Kombëtare Përfaqësuese Rinore e kanë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë, të cilat pranojnë qëllimin, fushën e veprimtarisë dhe përcaktimet e tjera të kësaj organizate, të rregulluara në statutin e saj.

3. Kriteret që duhet të përmbushë Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore, për t'u njohur si e tillë nga institucioni përgjegjës për rininë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU III
PUNA RINORE

Neni 14
**Puna rinore**

1. Punë rinore është çdo veprimtari e natyrës sociale, kulturore, arsimore, mjedisore nga/me ose për të rinjtë, në grupe ose individualisht, që ka për qëllim të motivojë dhe të mbështesë të rinjtë, duke kontribuar në zhvillimin e tyre personal dhe social dhe në zhvillimin e shoqërisë në përgjithësi.

2. Puna rinore realizohet nëpërmjet angazhimit dhe aktivizimit të të rinjve në veprimtari që reflektojnë nevojat, interesat, idetë dhe eksperiencat e tyre. Nëpërmjet këtij procesi të të nxënit joformal, të rinjtë fitojnë njohuri, aftësi, vlera dhe qëndrime që nevojiten për zhvillimin personal, integrimin social dhe qytetarinë aktive.

KREU IV
FINANCIMI

Neni 15
**Burimet e financimit**

1. Burimet e financimit për realizimin e politikave, programeve dhe projekteve rinore janë si më poshtë:

a) fondet grant nga buxheti i shtetit i dedikuar për rininë;

b) buxhetet vendore;

c) të ardhura të gjeneruara nga organizatat rinore;

ç) donacionet;

d) sponsorizimet;

dh) burime të tjera të ligjshme.

2. Fondet e buxhetit të shtetit për rininë përcaktohen në buxhetin vjetor të shtetit, për ministrinë përgjegjëse për rininë.

3. Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 16
**Financimi i politikave, programeve dhe projekteve rinore**

1. Fondi grant i dedikuar për rininë, sipas nenit 15, pika 1, shkronja "a", të këtij ligji, përdoret vetëm për:

a) financimin e ndërtimit apo të rikonstruksionit të objekteve publike dhe të infrastrukturës rinore;

b) financimin e projekteve të organizatave rinore dhe për të rinjtë;

c) bashkëfinancimin për pjesëmarrje në programe ndërkombëtare.

2. Projektet e ndërtimit ose rikonstruksionit të objekteve publike dhe infrastrukturës rinore, paraqiten dhe miratohen në përputhje me procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, duke garantuar zbatimin e elementeve të përshtatjes së arsyeshme, sipas legjislacionit në fuqi për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar.

3. Planifikimi dhe zbatimi i procedurave të shpërndarjes së fondit grant të dedikuar për rininë, procedurat e përzgjedhjes, kontratat e nënshkruara me organizatat përfituese, si dhe raportimet për shpenzimin e fondeve të dhëna, sipas këtij ligji, publikohen në faqen zyrtare të institucionit përgjegjës për rininë.

4. Institucioni përgjegjës për rininë shkëmben informacion me institucionin përgjegjës për mbështetjen e shoqërisë civile për organizatat rinore ose për organizatat për të rinjtë përfituese të fondit grant të dedikuar për rininë.

KREU V
INFRASTRUKTURA RINORE

Neni 17
**Infrastruktura rinore**

1. Infrastruktura rinore përbëhet nga pasuritë e paluajtshme, pronë publike, të destinuara apo të vëna në dispozicion për aktivitete dhe veprimtari rinore.

2. Infrastrukturë publike rinore janë pasuri të paluajtshme, në pronësi të pushtetit qendror ose vendor, sipas juridiksionit të vendndodhjes territoriale të tyre, të destinuara apo të vëna në dispozicion për aktivitete dhe veprimtari rinore.

3. Pronarët apo administratorët e infrastrukturës janë përgjegjës për ndërtimin, rindërtimin, ruajtjen, mirëmbajtjen dhe shërbimet, si dhe krijimin e kushteve për funksionimin normal të tyre.

4. Infrastruktura rinore ndërtohet, rindërtohet, përshtatet dhe mirëmbahet në funksion dhe për krijimin e kushteve për ushtrimin e veprimtarive për rininë, në përputhje me standardin e hapësirave rinore të sigurta.

5. Ndërtimi i infrastrukturës rinore bëhet në përputhje me standardet dhe kushtet teknike të miratuara nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën.

6. Pjesë e infrastrukturës rinore janë dhe pasuritë e luajtshme, të destinuara apo të vëna në dispozicion për aktivitete dhe veprimtari rinore.

7. Pronarët apo administratorët e pasurive garantojnë rregullat teknike të sigurisë higjieno-sanitare dhe shëndetësore, të aksesueshme për shfrytëzimin dhe frekuentimin e rregullt e normal të mjediseve për rininë dhe të rinjtë, në përputhje me standardin e hapësirave të sigurta.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT
Neni 18

**Baza e të dhënave për rininë**

1. Qëllimi i bazës së të dhënave për rininë është të sigurojë informacion të përditësuar për të rinjtë në vend, si edhe të mbështesë procesin e planifikimit, mbikëqyrjes, administrimit dhe vlerësimit të politikave rinore, në nivel qendror dhe vendor.

2. Baza e të dhënave për rininë përmban si më poshtë:

a) të dhënat parësore, që kanë të bëjnë me organizata rinore dhe për të rinjtë, në vend dhe në diasporë, Organizatën Kombëtare Përfaqësuese Rinore, politikat rinore kombëtare, vendore dhe europiane;

b) të dhënat dytësore, që kanë të bëjnë me financimin e projekteve dhe veprimtarive rinore, studime, analiza, vlerësime, vëzhgime dhe vlerësime të zbatimit të politikave rinore.

3. Institucioni përgjegjës për rininë administron bazën e të dhënave që ka të bëjë me të rinjtë, përmbajtja e së cilës publikohet në portalin "Për rininë" dhe realizon ndërveprimin e përmbajtjes së

tij me bazat e tjera të informacionit, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Rregulla të hollësishme për mënyrën e ngritjes, administrimit, mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për rininë, si dhe mënyrën e ndërveprimit të saj me bazat e tjera të të dhënave shtetërore miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale sipas parashikimeve të këtij neni, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 19
**Miratimi i akteve nënligjore**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të nenit 8, pika 3, nenit 9, pika 3, nenit 13, pika 3, nenit 15, pika 3, dhe nenit 18, pika 4, të këtij ligji.

Neni 20
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 4.11.2019.

## VENDIM
## Nr. 143/2019

## PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR ZGJATJEN E AFATIT TË GJENDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE

Në mbështetje të neneve 100 dhe 174, pika 2, të Kushtetutës dhe të shkronjës "d", të nenit 18, të ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Dhënien e pëlqimit për zgjatjen e afatit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, shpallur me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë", të ndryshuar, deri në datën 31.3.2020.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 18.12.2019.

## VENDIM
## Nr. 144/2019

## PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 11 343, DATË 6.11.2019, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS, "PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 71/2019 'PËR KORPORATËN E INVESTIMEVE SHQIPTARE'"

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 11 343, datë 6.11.2019, të Presidentit të Republikës, "Për kthimin e ligjit nr. 71/2019, 'Për Korporatën e Investimeve Shqiptare'".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 18.12.2019.

**VENDIM**
**Nr. 145/2019**

